

VENDIM
Nr.440, datë 27.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE
MËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2 “Paga e grupit”, e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Punonjësit mësimorë efektivë që, për nevoja të procesit mësimor, japin orë mësimi mbi normën e lejuar mësimore, paguhen për çdo orë mësimore shtesë, në masën:

- Në shkollat e mesme 300 lekë;
- Në shkollat 9-vjeçare 250 lekë.

Punonjësit e jashtëm, të specialiteteve të ndryshme, që japin mësim në shkollat e mesme, në shkollat teknike e profesionale, si dhe në kurset e ndryshme (me përjashtim të kurseve, që ngrihen pranë shkollave të larta dhe institucioneve të tjera të kualifikimit të punonjësve mësimorë), për çdo orë mësimore shpërblehen në të njëjtën masë me punonjësit mësimorë efektivë, si më sipër. ”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2009, të parashikuara për rritjen e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

**STRUKTURA E PAGËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

	Emërtimi	Paga mujore			
		Paga individuale			Shtesa e pozicionit
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikimin (SHK)	
		1	2	3	4
1	Drejtor i shkollës së mesme.Përgjegjës poligoni Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë. Drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë. Drejtor në shkollat me probleme të larta mendore. Drejtor i konvikteve.	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	45000
2	Zëvendësdrejtor i shkollës së mesme. Përgjegjës i bazës prodhuese. Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë. Zëvendësdrejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë. Zëvendësdrejtor në shkollat me probleme të larta mendore. Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve.	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	40000
3	Drejtor i shkollës 9-vjeçare	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	36000
4	Drejtor i shkollës fillore klasa I-IV Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive. Zëvendësdrejtor i shkollës 9-vjeçare. Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve.	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	34500
5	Drejtor i kopshtit me ushqim	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	33000
6	Drejtor i kopshtit pa ushqim	1			30000
7	Mësues në shkollat e mesme. Mësues në institutin e nxënësve që nuk shikojnë. Mësues në institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë. Mësues në shkollat me probleme të larta mendore. Inspektor në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	33000
8	Mësues në shkollat 9-vjeçare, klasa I-IX Eduktor konvikti. Kujdestar konvikti.	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	30000
9	Eduaktor në kopsht fëmijësh	1	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	27500
10	Mësues	2	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	24500
11	Mësues	3	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	24500

12	Edukator në kopësht fëmijësh.	3	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	22 500
13	Edukator në kopësht fëmijësh.	2	2% e P.G.	5% e P.G. 10% e P.G. 20% e P.G.	22 500

Lidhja nr.2

VLERA E PAGËS SË GRUPIT SIPAS NIVELIT ARSIMOR

Grupi	Paga në lekë
1	12000
2	10000
3	8000
4	6000